



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5122 Prot

Gjirokastër më 3 : 6 :2025

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së dates 30.05.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates. 30.05.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 30.05.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:05

Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Cacaj, Aliko, Shehaj, Kristidhi, Feruni, Drasa, Manjola Shehaj, Aliko, Pandos, Peta, Leskaj, Çabeli.

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së dates 30.04.2025

2. P/V “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.05.2025-31.05. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.05-31.05 2025

4. P/Vendim “Për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë sezonit veror në sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave në territorin e Bashkisë Gjirokastër”.

5. P/Vendim “Për për zgjedhjen e përfituesve (individë, familje) për subvencionin e kredisë së butë të financuar nga Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Bashkisë Gjirokastër”

6. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Gjithashtu paraqitet edhe pika shtesë e cila ka të bëjë me transferimin e fondeve të huaja.

P/V “Për transferimin e fondeve të huaja për projektin “Tour”, “Ecobase” dhe “Adriamove”.

Z. Brahimi: Kërkon informacion për arsyen pse vjen me vonesë dhe jashtë rendit të ditës.

Artiste Koko; Ky project është I miratuar në dhjetor 2024 me buxhetin e miratuar për këtë vit, tani jemi ne fazën e likuiditetit . Kanë ardhur fondet.

SEKRETAR

Znj.Isaraj ;Hidhet në votë rendi i ditës dhe miratohet me 18vota pro dhe një kundër, z. Brahimi.
Hidhen në vote dhe miratohet me 19 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 30.04.2025.
Hidhen në vote dhe miratohen me 19 vota pro 2 p/vendimet e ndihmës ekonomike për muajin Maj 2025.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.05. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin .01-31.05.2025”.

Hidhet në votë pika 4 P/Vendim “Për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë sezonit veror në sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave në territorin e Bashkisë Gjirokastrë” dhe miratohet me 20 vota pro.

Z. Brahimi: Ne kemi miratuar blerjen e një zjarrfikseje, çfarë është bërë deri tani?Au ble?

Z. Nebiaj: Është në procedurë prokurimi.

Vjen z. Kristidhi.

Z. Hilaj: Po në lidhje me punonjësit që u miratuan?

Znj. Koko: Ka filluar zbatimi dhe kontraktimi në bashkëpunim me zjarrfikësen.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës.Ka kaluar në komision.

Z.Brahimi:Materiali është i qartë. Jam dakord me materialin.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për përzgjedhjen e përfituesve (individë, familje) për subvencionin e kredisë së butë të financuar nga Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Bashkisë Gjirokastrë”

Kalohet te pika shtesë P/V “Për transferimin e fondeve të huaja për projektin “Tour”, “Ecobase” dhe “Adriamove”. Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro.

Mbyllet mbledhja .

Mbyllet mbledhja në orën 12:35 min.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

